



# DITARI MUJOR

TETOR 2023

## Forumi “Kërkimi Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”

U zhvillua Forumi për “Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë 2023”, me synim nxitjen, orientimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë. Për vitin 2023, janë financuar 90 projekte të kërkimit shkencor dhe 17 projekte të infrastrukturës akademike, përmes Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Ministria e Arsimit dhe sportit do të rrisë mbështetjen për kërkimin shkencor në universitete, duke mbështetur qasjen e orientuar drejt nevojave të tregut, në bashkëpunim me biznesin, studiues dhe kërkues shkencorë vendas dhe të diasporës, me qëllim përfitimin e produkteve shkencore dhe inovative, që i vlejné zhvillimit ekonomik e social të vendit.



## “Zgjidh Zanatin”


Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, kanë nisur fushatën e komunikimit “Zgjidh Zanatin”, për orientimin e nxënësve drejt arsimit profesional, si çelësi i suksesit për punësimin e sigurt. Ministria e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu tha se, komunikimi intensive dhe mundësia e nxënësve që sapo kanë nisur gjimnazin, për t’u transferuar në arsimin profesional brenda muajit dhjetor, do t’i japin një hov të ri orientimit drejt arsimit profesional të nxënësve, për të zhvilluar aftësitë në zanatet më të kërkuara nga tregu i punës.



## Dokument i ri politikash për arsimin e lartë

Ministria e Arsimit dhe Sportit së bashku me universitetet do të hartojnë një dokument të ri politikash, me synim për të ecur më shpejt me ndërkombëtarizimin dhe profilizimin e universiteteve, për ta bërë ofertën akademike universitare sa më atraktive dhe konkurruese. Në nisje të vitit të ri akademik, Ministria e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu, në ceremoninë e zhvilluar me studentë e pedagogë të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, foli edhe për mbështetjen e studentëve nëpërmjet bursave për programet prioritare, për t’ju përgjigjur kërkesave të kohës. Mbi 121 mijë studentë pjesë e universiteteve publike dhe jopublike janë ulur këtë vit në auditore.

## Kolegji i Evropës në Tiranë



Çelet një epokë e re për ndërkombëtarizimin e universiteteve, me marrëveshjen që i hap rrugën ngritjes së kampusit të Kolegjit të Evropës në Shqipëri. Hapja e zyrës së përfaqësimit të Kolegjit të Evropës në vendin tonë, u bë në praninë e liderëve të Bashkimit Evropian, gjatë Samitit të Berlinit, që zhvilloi punimet në Tiranë. Më herët, Memorandumi i Mirëkuptimit u nënshkrua nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu, Rektorja e Kolegjit të Evropës, Federica Mogherini dhe Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliqaj. Hapja në Tiranë e Kampusit të Kolegjit të Evropës është një moment historik, në kuadër të ndërkombëtarizimit të universiteteve dhe të përafrimit të vendit tonë me Bashkimin Evropian.

## “FLASIM PËR ARSIMIN”

“Flasim për Arsimin” është një nismë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu, për të shkëmbyer ide dhe marrë sygjerime nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit, për përmirësimin e procesit mësimor në shkolla. Mësuesit e shkollave në Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Berat, etj, sugjeruan zgjerimin e laboratorëve dhe bazës materiale, rritjen e aksesit në teknologji, zgjerimin e ambienteve si dhe më shumë mbështetje për mësuesit. Fushata e komunikimit “Flasim për Arsimin”, do të vijojë me mësues-prindër-nxënës në të gjitha shkollat e vendit.



## “BIBLIOTEKA IME NË SHKOLLË”

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka nisur programin “Biblioteka ime në shkollë”, që synon të kontribuojë në zgjerimin e fondit të librave të bibliotekave për nxënësit. Me këtë program synohet të zgjerohen horizontet e nxënësve, duke i nxitur kreativitetin dhe duke i ushqyer dashurinë për leximin dhe dijen. Më shumë se 13 mijë libra artistikë dhe shkencorë do të dorëzohen në mbi 500 shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, përgjatë këtyre javëve.